



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME” DIBËR sh.a

Nr. _____ prot.

Datë 24.05.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Data: 24.05.2024

Drejtuar: Operatorit Ekonomik, “SHANSI INVEST” sh.p.k me të dhëna si më poshtë:

- Shoqëria “SHANSI INVEST” sh.p.k me NIPT J61924002T me adresë: Tiranë, Rruga Reshit Çollaku, Pallati 4, Shkalla 8, Apartamenti 7.

Procedura e prokurimit: Proçedurë e hapur me mjete elektronike / Punë.

Numri i referencës së proçedurës: **REF-00192-04-04-2024.**

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 45247130-Punime ndërtimi për ujësjellës.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Ndërtimi i Linjës së dërgimit Depo Lis,Burrel,Faza II”.

Afati kohor për ekzekutimin: 30 (tridhjetë) muaj

Fondi limit: 425,37,155 (katërqind e njëzetë e pesë milion e treqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e njëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme: Nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- Oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto
- Oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi, ju informojmë se në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik Shoqëria “La-Or” sh.p.k me NIPT K71420003R me adresë: Tiranë, Berzhitë, Autostrada Tiranë - Elbasan , Km.6, " PALMA NOVA
Vlera e Ofertës: 410,015,662.35 (katërqind e dhjetë milion e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH
2. Operatori Ekonomik Shoqëria “SHANSI INVEST” sh.p.k me NIPT J61924002T me adresë: Tiranë, Rruga Reshit Çollaku, Pallati 4, Shkalla 8, Apartamenti 7.
Vlera e Ofertës: 403,555,005 (katërqind e tre milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesë) lekë pa TVSH.

Oferta të refuzuara:

1.Operatori Ekonomik Shoqëria “La-Or” sh.p.k me NIPT K71420003R me vlerë të ofertës 410,015,662.35 (katërqind e dhjetë milion e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

S`kualifikohet

Nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik në SPE për këtë procedurë prokurimi rezulton se:

Nuk përmbush kriterin 2.3.2 pikën c të kriterëve të veçanta të kualifikimit publikuar në DST për kapacitetin teknik dhe profesional pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument siç kërkohet në DST referuar Rakorderive dhe Brryla Gize sipas kërkesave të bëra nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Gjithashtu nuk përmbush kriterin 2.3.2.c pika 3 nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion/ vetëdeklarimi që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015 (ose ekuivalente); ISO 45001-2018 (ose ekuivalente); 26000:2020 (ose ekuivalente); dhe të pajisur me certifikatë produkti sipas standartit UNI EN 545:10 – UNI ENI 598:08-ISO 2531:09 – ISO 7186:11, duke mos përmbushur kërkesat e bëra nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Nuk përmbush paragrafin 2.3.3 gërma d të kriterëve të veçanta të kualifikimit publikuar në DST, Kapitulli “Kapaciteti teknik dhe profesional” në lidhje me kërkesat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor për stafin që duhet të disponojë operatori ekonomik, pasi në licencën e shoqërisë figuron vetëm 1 (një) montator nga 4 (katër) që kërkohen, mungojnë 3 (tre) shoferë, ka 2 manovrator/eskavatorisë nga 4 (katër) që kërkohen, duke mos përmbushur kërkesat e bëra nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Nuk përmbush kriterin 2.3.5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit publikuar në DST për kapacitetin teknik dhe profesional në lidhje me makineri pajisje pasi nuk ka paraqitur makineritë: Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton; Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton; Kamionçina; Rimorkiator për transportin e makinerive; Betoniere të vogla; Autopompë Betoni; Autobetoniere; Autobitumatrice; Vibrator Betoni; Makineri Prerëse / Sharrë Betoni; Autobot uji; Pompë uji; Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion”; Matës largësie / Instrument për Topogjeodezim; Matrapik; Sharrë për prerje asfalti; Aparat hekurkthyes; Motogjenerator; Makineri për shpime horizontale nëntokësore mikrotunele me drejtim me lazer me diametër DN 300mm, DN 400 mm;

Gjithashtu nuk përmbush kriterin 2.3.5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit publikuar në DST për kapacitetin teknik dhe profesional në lidhje me mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr.312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si më poshtë vijon:

- Kokore + Jelekë fosforoshente
- Fikëse zjarri të lëvizshme
- Prozhektorë ndriçimi natën
- Komplet i ndihmës së shpejtë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt

Referuar të gjithë mangësive në kapacitetet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në DST Operatori Ekonomik **Shoqëria “La-Or” sh.p.k** s`kualifikohet.

Sa më lart, bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s`kualifikimin e Operatorit Ekonomik Shoqëria “La-Or” sh.p.k

Oferta të kualifikuara:

2.Operatori Ekonomik “Shansi Invest” sh.p.k me NIPT J61924002T me vlerë të Ofertës: 403,555,005 (katërqind e tre milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesë) lekë pa TVSH.Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Shansi Invest” sh.p.k, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, konkludon se ky Operator Ekonomik plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranimi /Kualifikimit.

Ky Operator dokumentacionin ligjor, administrativ dhe teknik e ka të rregullt konform kërkesave të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Gjithashtu plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në zbatim të Legjislacionit të Prokurimit Publik, VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Referuar nenit 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor ka vendosur të pranojë ofertën e Operatorit Ekonomik “Shansi Invest” sh.p.k, si dhe të kualifikojë si ofertë të vlefshme ofertën e paraqitur prej tij.

Autoriteti Kontraktor në përfundim konkludoi:

Oferta të refuzuara:

1.Operatori Ekonomik Shoqëria “La-Or” sh.p.k me NIPT K71420003R me vlerë të ofertës 410,015,662.35 (katërqind e dhjetë mijon e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Oferta të kualifikuara:

1.Operatori Ekonomik “Shansi Invest” sh.p.k me NIPT J61924002T me vlerë të Ofertës: 403,555,005 (katërqind e tre mijon e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesë) lekë pa TVSH.

Duke u nisur nga renditja e operatoreve ekonomikë të kualifikuar, në bazë të kriterit të përzgjedhjes Çmimi më i ulët, konkludohet se Oferta fituese është Oferta e Operatorit Ekonomik Shoqëria “Shansi Invest” sh.p.k me NIPT J61924002T, me vlerë të ofertës 403,555,005 (katërqind e tre mijon e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesë) lekë pa TVSH.

Pas paraqitjes nga Operatori Ekonomik Shoqëria “Shansi Invest” sh.p.k, të dokumentacionit provues të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ky operator ekonomik rezultoi me dokumentacionin ligjor, administrativ dhe teknik të rregullt konform kërkesave të Dokumentave Standarte të Tenderit të publikuara nga Autoriteti Kontraktor.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik Shoqëria “SHANSI INVEST” sh.p.k me NIPT J61924002T me adresë:Tiranë, Rruga Reshit Çollaku, Pallati 4, Shkalla 8, Apartamenti 7, me ofertë të paraqitur me një vlerë totale prej 403,555,005 (katërqind e tre mijon e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesë) lekë pa TVSH/ totali i pikëve të marra [____]; se është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Dibër Sh.a, me zyra në adresën Lagjia Minatori, Pallati i Kulturës, Bulqizë, Shqipëri, **sigurimin e kontratës**, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes / publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe do të vepohet sipas parashikimeve në nenin 83 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO **JO**

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erger KOSIQI

(emri, mbiemri, firma, vula)